

## Tryezë diskutimi në Universitetin e Elbasanit në bashkëpunim me Fondacionin Westminster për Demokraci dhe Institutin Parlamentar

Fondacioni Westminster për Demokraci, në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit dhe Institutin Parlamentar zhvilluan një tryezë diskutimi me temë "Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e vlerësimit të hapësirave për korrupsion në legjislacionin shqiptar".

Kjo tryezë bëri bashkë profesionistë ligjorë, akademikë dhe studentë, për të eksploruar kornizat teorike, rastet studimore dhe qasjet praktike, për të rritur transparencën, pasuruar kurrikulën universitare si edhe identifikimin e mundësive të bashkëpunimit mes botës akademike dhe politikbërëseve.



